



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Korçë, më 29. 03. 2024
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

NJOFTIM

PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONIN E MËSUESIT

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) Korçë, njofton të gjithë kandidatët që kanë përfunduar studimet universitare në fushën e edukimit (mësuesisë) dhe plotësojnë kriteret ligjore në fuqi, kandidatë që nuk kanë rezultuar të suksesshëm në sesionet e mëparshme të provimit të shtetit si edhe të gjithë kandidatët që janë duke ndjekur praktikën profesionale gjatë tremujorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024 të regjistrohen ose të konfirmojnë marrjen pjesë në sesionin e radhës **maj 2024** të Provimit të Shtetit.

- ✓ Kandidati që dëshiron të regjistrohet për pjesëmarrje në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, aplikon online duke përdorur shërbimin e ofruar në Portalin Qeveritar e-Albania “Aplikimi për provim shteti”.
- ✓ Kandidati kualifikohet për pjesëmarrje në provimin e shtetit kur:
 - Ka kryer me sukses praktikën profesionale;
 - Ka rezultuar jo i suksesshëm në sesionet e kaluara;
 - Nuk është paraqitur në sesionet e mëparshme;
 - Është në marrëdhënie pune dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, në fushën e mësuesisë.
- ✓ Kandidati gjatë aplikimit online ngarkon në sistem dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Diplomën e ciklit të parë të studimit;
 - Diplomën e ciklit të dytë të studimit;
 - Certifikatën e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale;
 - Vetëm pas pranimit nga DRAP Korçë, ngarkon faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA, e cila duhet të kryhet brenda 72 orëve dhe të ngarkohet në sistem.
- ✓ Kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit ose në institucione të arsimit të lartë të mbyllura, duhet të ngarkojnë:
 - Vërtetimin për njohjen dhe njehsimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit;
 - Dokumentacionin e lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës/diplomave, të fituara nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur dhe vërteton vlefshmërinë e tyre.
- ✓ Kandidatët, të cilët rezultojnë të suksesshëm në provimin e shtetit, menjëherë pas përfundimit të provimit, kanë të drejtë t'i nënshtrohen direkt testimit të informatizuar të mësuesit, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Regjistrimet për provimin e shtetit fillojnë nga data

01.04.2024 deri në datën 07.04.2024.